



Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo

Komuna e Rahovecit

Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport



REPUBLIKA E KOSOVËS, REPUBLIKA KOSOVO / REPUBLIC OF KOSOVO KOMUNA RAHOVEC/PLATNA GRANO VUČAK/PLATELLA PLATNA KABINET KUSTODIT TE KOMUNES/PLATNA GRANO VUČAK/PLATELLA PLATNA Njësia Nr./Br./No. 02/Kabinet i Kustodit te Komunës Nr./Br./No. 5089/Nr. i fap/Bz/str/No. pg. 21 Data/Datum/Date 25/ 9/23 RAHOVEC / ORAHOVAC
--



RAPORTI NËNTË MUJOR- 2023

Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport

TABELA E PERMBARJES

Drejtoria për Kulturë, Rinji dhe Sport

Isternacionali Shkollat e Artit Kulturoren, Rrjedh Sportit ne Rahovec

Aktivitetet e Muabit Janar - Qershor

Biblioteka Komunale "Sulejman Krashnić"

Palestra Sportive "Mizahir Isma"

DREJTORIA PËR KULTURË, RINI DHE SPORT

Letërnjoftimi i shkurtër lidhur me Kulturën, Rini dhe Sportin në Rahovec.

Komuna e Rahovcit shtrihet në pjesën veriperëndimore të Republikës së Kosovës. Është ndër qytetet më të vjetra të Kosovës, me relikte antike të trashëguara nga epokat e hershme ilire-romake, objekte të trashëgimisë arkitekturore, shpirtërore, fetare, etnologjike etj. Turizmi kulturor kryesisht mund të jetë i bazuar në trashëgimikulturore/ arkitekturore: shtëpitë tradicionale, turizëm arkeologjik, shpella, trashëgimi arkitekturore dhe fetare. Në komunën e Rahovcit zhvillohen aktivitete të ndryshme kulturore, rimore e sportive, aktivitetet muzikore, teatrale, bibliotekare, eksposita, festivalë e aktivitete të ndryshme kulturo. Aktivitetet të ndryshme zhvillohen në qendrat kulturore në Rahovec, Krushë të Madhe, Hoçë të Madhe, Ratkoc, Xerxë, Drenoc e gjetkë. Biblioteka Komunale "Sulejman Krashiqi", me degët në Krushë të Madhe, Ratkoc e Hoçë të Madhe me mbi 27.814 ekzemplarë, si qendrat sportive në Rahovec, palestra "Mizahir Isma", terrenet e sportit në Krushë të Madhe, Xerxë, Ratkoc, Dejnë dhe në disa lagje të qytetit, ofrjnë mundësi të mira për zhvillimin e sportit e rekreativit. Po ashtu, funksionojnë shoqëritë kulturore-artistike, grupet muzikore e artistike, shoqatat e ndryshme, një qendër rimore aktive, që zhvillojnë aktivitete në këto objekte kulturore, rimore e sportive. Ndërkohë aktivitetet kryesore kulturore e promovuese që organizohen në komunën e Rahovcit janë; festivali i folklorit "Anadria Jehon" festa e Vjeljes së rrushit "Hardh Fest", "Agrofesta", Festivali Ndërkombëtar i Poezisë, si dhe aktivitete të ndryshme periodike kulturore, rimore, sportive e promovuese.

Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport e përbërë prej tre sektorëve: Kulturë, Rini dhe Sport, me një buxhet të caktuar, i mbulon tre fusha të rëndësishme në jetën e përditshme.

Aktivitetet që i përfshin drejtoria janë: aktivitetet rimore, sportive, ruajtja e trashëgimisë kulturore, shfaqjet teatrale, muzikë, art.

- Në raport të punës janë të përfshira shumica e aktiviteteve të zhvilluara në drejtori, duke përfshirë aktivitete e projekte, në fushën e kulturës, trashëgimisë kulturore e historike, bibliotekarisë, sportit dhe rinisë.
- Personeli i DKRS-së përgjatë kësaj periudhe, është angazhuar që të gjitha projekte e aktivitete të parapara të përfundohen me sukses, duke bërë përpjekje edhe për sigurim të mbështetjes financiare shtesë, përfshirë mbështetje nga niveli qendror; MKRS dhe donatorë të ndryshëm vendor e ndërkombëtar.
- Bashkëpunimi me OJQ-të, strukturat e pushtetit lokal, organizatat ndërkombëtare që veprojnë në Kosovë dhe donatorë të ndryshëm, ka qenë konstruktiv dhe ka rezultuar me sukses në disa prej aktiviteteve të realizuara përgjatë kësaj periudhe.

Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport poashtu trajton kërkesat e palëve për shfrytëzimin e këtyre objekteve kulturore e sportive:

- Shtëpia e Kulturës në: Rahovec, Ratkoc, Xerxë, Krushë të Madhe dhe Drenoc.
- Bibliotekën "Sulejman Krasniqi" në Rahovec, Krushë të Madhe dhe Hoçë të Madhe.
- Stadiumin "Jahja Danuza" në Rahovec dhe fushat tjera sportive.
- Palestrën "Mizahir Isma".

Përveq buxhetit të caktuar komunal, drejtoria ka bërë përpjekje për të gjetur edhe burime të tjera financiare përmes bashkëpunimit me OJQ, organizatat ndërkombëtare që veprojnë në vendin tonë, strukturat e pushtetit lokal, donatorë të ndryshëm, duke përfshirë edhe pushtetin qendror MKRS-në.

Çfarë kemi arritur?

Shënimet e mëposhtme përmblledhin aktivitetet kryesore dhe të arriturat e DKRS-së nga janari deri në Shtator të vitit 2023. Informata më të hollësishme janë dhënë në aneksin e këtij raporti, që ofron informacion të hollësishëm të veprimtarisë së DKRS-së.

AKTIVITETET:

Gjatë muajve Janar-Shtator Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport ka organizuar aktivitetet të ndryshme si pas planit të punës:

Vitin e kemi nisur me organizimin e manifestimeve përkujtimore e kulturore 27 Janar "Flaka e Janarit", me ç'rast është shpallur konkursi letrar "Pena e Flakës".

Aktivitet kulturore e sportive në shënim të Ditës së pavartësisë më 17 shkurt.

Në bashkëpunim me OVL- UÇK-n kemi organizuar aktivitetet për ndërë të Epopes së UÇK-së më 5,6,7 mars.

Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport ka vazduar me mbështetjen projekteve të OJQ-ve të cilat veprimitarin e tyre e ushtrojnë në komunën tone, këtë vit përfitues nga subvencionet kanë qenë 23 OJQ në shumë prej 157.100eu, gjatë viti 2023 OJQ-të kanë përfituar 30% më shumë se vitin e kaluar, ku kjo mbështetje do të vazhdoj për çdo vit.

Java e Dëshmorëve 5-12 maj, Festivali i folklorit Anadrinia jehon më 11,12,13 maj.

Aktivitet me 14 Qershor Dita e çlirimt, më 17 Qershor shënimi i ditëlindjes së kolosit të kombit tonë Ukhin Hoti dhe ndarja e Dekoratës për shkrimitarın Ismail Kadare, Pësurimi i Kompleksit muzeor "UKSHIN HOTI" në Krushë të Madhe

Gjatë kësaj periudhe Janar-Shtator, në bashkëpunim me Drejtorinë e Arsimit, me nxënësit e shkollave të mesme kemi organizuar vizita në objektet që janë në kuadër të drejtorisë, si në Kopleksin Memorial në Gradish, Kullën e Heronjëve në Opterushë etj.

Investimet Kapitale:


Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport jemi duke punuar në ndërtimin e tereneve sportive ku me datë 27.04.2023 është bërë përrimi i fushës sportive në fshatin Gexhe.



- Punimet në ndërtimin e fushës sportive në Malësi të Vogël kanë filluar me datë 03.05.2023 dhe dhe përvimi i kësaj fushë në Malësi të Vogël është bërë më 30.08.2023, projekti për rregullimin e fushave sportive do të vazhdoj në të gjitha vendbanimet e komunë sонë.
- Ndërtimi i Kompleksit Muzeor "Ukshin Hoti" në Krushë të madhe, përvimi i kompleksit është bërë me 17 Qershor 2023.



- Ndërtimi i Aneksit të shtëpia e Kulturës në Krushë të Madhe, punimet janë duke vazhduar dhe jemi në fazën përbyllëse të punimeve, përvimi i këtij objekti do të bëhet në fund të muajit Tetrok.
- Ndërtimi i Kompleksit Sportiv, punimet janë duke vazhduar në rregullimin e ketij kompleksi ku do të ketë një fushë të futbolit të madh, dy fusha të basketbollit, dhe shtegun e Atletikës.
- Në kuadër të projektit "Ndërtimi i parqeve dhe këndëve rekreative për fëmijë" është bërë rregullimi i Parkut te stacioni i autobusave.
 - ❖ DKRS-ja do të vazhdoj me rregullimin e parqeve dhe këndet e lojrave për fëmijë edhe në vendbanimet tjera. Shtimi i hapësirave të gjelbëruara është një nga prioritetet e Komunës së Rahovecit, duke mundësuar kështu që qytetarët të pushojnë dhe kalojnë kohë më shumë në mëjisë të hapur.



Parku te Stacioni i Autobusave.

Janë organizuar aktivitetet për "Muajin e mërgimtarëve", nga data 15 korrik dhe janë përmbyllur më

15 gusht,


Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport, në bashkëpunim edhe me drejtoritë tjera komunale si drejtorinë për Administratë, Drejtorin e Arsimit, Drejtorin për Ekonomi, Drejtorin për Bujqësi dhë Zyrën e Kryetarit, kanë organizuar aktivitetet të shumta si: Turne në futboll dhe shah, koncerte argëtuese në Rahovec, Xerrxe, Ralkoc, Çiflik, Drenoc, Opterushë dhe Krushë të Madhe u mbajt "Agro Festa" ku kanë prezantuar grupe dhe muzikantë të njohur, siç janë: "Sabri fejzullahu", "Vesa Luma", e këngëtarë të tjere.

Ndër aktivitetet e pëlqyeshme ka qenë edhe organizimi i veprimitarit "Sofra e mërgimtarit", që është pritur shumë mirë nga qytetarët dhe kemi kërkesa që vitin e ardhshëm të organizohet edhe në vendbanime të tjera.


Përveç këtyre aktivitetet e organizua edhe turneu në Shah për penzionista në fshatin Ralkoc ku moren pjesë edhe kurbeqarë në këtë turne, mërgimtarët kanë pasur mundësi të marrin pjesë edhe në turneun e futbolit, që u organizua enkas për dashamirësit e këtij sporti.

Pjesëmarja e madhe e qytetarëve në këto aktivitetë nga data 15 korrik deri më 15 gusht, është dëshmia më e mirë se organizimet kanë qenë në nivel ditë se janë përbushur në masë të koniderueshme përfjet e mërgimtarëve tanë, aktivitetet e organizuar në qytet pikërisht në rrugën "Xhevrat Kaspi" janë organizuar në bashkëpunim me bizneset të cilët veprimtarinë e tyre e ushtronin në atë pjesë, ku edhe i falenderojmë për bashkëpunim të cilët kanë dhënë kontributin e tyre në muajin e mërgimtarëve. Në të gjitha aktivitetet e mbajtura kanë qenë prezent Policia e Kosovës-Stacioni Policor në Rahovec të cilëj janë kujdeus për mbarëvajtjen dhe sigurinë e qytetarëve, ku shfytëzojmë rastin ti falenderojmë për bashkëpunim të cilëi janë të gatshëm çdo here të ofojnë siguri për qytetarët.

Sipas të dhënave të vëzhguesve tanë, në këto aktivitetë duke filluar nga Qyteti e në të gjitha vendbanimet tjera ku janë mbajtur aktivitetet kanë marrë pjesë rreth 16,000nijë qytetarë



Në kompleksin e dëshmorëve në gradish është organizuar koncert shumë cilësor me këngëtarë të njohur dhe me artistë të rinj po ashtu kishte pjesmarres edhe artist nga mërgata.




• Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sporte e Komunës së Rahovecit në bashkë organizim me shkollën e futbolit Anadrini, në kuadër të aktiviteteve të shumta kushtuar Mujt të mërgimtarëve, kan realizua me sukses edhe turniin në futboll të vogël "Anadrini Cup".

Aktivitetet u zhvilluan në fushën e futbolit në SHML 12 Maji në Ratkoc.



• Giak muajt korrik është dhënë premiera e shfaqjes teatrale nga të rinjtë e Qendres Rinore SHL-KOSOSVA "QUO VADIS" nga regjisori Gjergj Mena. Kjo shfaqje është realizuar në bashkëpunim të plotë me Drejtorinë për Kulturë, Rini dhe Sport të komunës së Rahovecit në Qendren e kulturës "Mensur Zyberaj" në Rahovec




- Janë organizuar një sërë aktivitete e mbremje muzikore në bashkëpunim me lokalet të Palestra sportive "Mizahir Isma" me grupe e artist të njohur të estradës së Kosovës.
- Aktivitetet jan realizuar në rrugën Xhevati Kasapi në Rahovec.



- Është intervenuar në funksionalizimin e fushës së futbollit në fshatin Dejnë pas dëneve të shkaktuara gjatë vërsimit në vitin e kaluar, ku trash më fusha është në funksion të klubit të Anadrimit dhe po zhvillon garat në ligën e tretë.




- Në Malësi të Vogël është përvuar fusha sportive bashkëkohore dhe me infrastrukturë të kompletuar. Ky investim nga DKRS është pritur me një entuziazëm dhe gjëzim të madh në këtë mëjdis mund të



zhvillohen këto disciplina sportive përfutball, basketbolli dhe volejball, që do t'u shërbejnë të rinjve, nxënësve dhe të gjithë qytetarëve të fshatit përsport e rekreacion.

- Pas një pune me përkushtim të gruipit punues përhartimin e statutit të Ansamblit komunal më 30.08.2023 në mledhjen e rregullt të Kuvendit Komunal në Rahovec unanimisht u votua Statuti për themelimin e Ansamblit të Këngëve dhe Valleve të Komunës së Rahovëcit.



BIBLIOTEKA KOMUNALE "SULEJMAN KRASNIQI"-

RAHOVEC

- Përgaditja e raporteve mujore dhe vjetore
- Përpunimi fizik i materialeve bibliotekare

- Klasifikimi dhe katalogimi i librit.

Gjatë kësaj periudhe, kemi bashkëpunuar me dashamirë të librit: mësimdhënies, nxënës, shkrimitarë të komunës sonë, në mënyrë që të kemi ngritje të vetëdijes rrëth lexueshmërisë.

Biblioteka në tërsi ka ruajtur vazhdimësinë e punës së saj profesionale në shërbim të lexuesve, të atyre përdoruesve që kanë pasur nevoja për shërbime të ndryshme, si në kërkim të librit, në shfrytëzim të sallës dhe shërbimeve të tjera.

► Në Biblioteken Komunale "Sulejman Krasniqi" në Rahovec me 21.03.2023 u përrura Këndi Shkencor "Sabahajdin Cena".

❖ Ky kënd do t'iu mundësojë studiuesve dhe hulumtuesve shkencor që të kenë mundësi më të mira të studimit.

► Në kuadër të shënimit të Ditës Botërore të Poezisë, Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport organizoi orë letrare me krijues dhe nxënës të shkollave të mesme e fillore të Rahovcit.

Anëtarësia dhe libra të lexuara

Gushit	Anëtar	Meshkuj	Femra	Me pagesë	Falas	Libra të lexuara	Meshkuj	Femra
Rahovec	54	26	28	53	1	537	230	307
Krushië	17	3	14	17	0	139	36	103
Ratkoc	7	2	5	7	0	20	6	14
Gjithsej	78	31	47	77	1	696	272	424

Perbëria sociale e lexuesve

Gushit	Sh.Fillore	Sh.Mesme	Student-e	Punëtor-e	Bujq	Amvise	Të tjerrë	Gjithsej
Rahovec	50	2	1	0	0	0	1	54
Krushië	16	0	1	0	0	0	0	17
Ratkoc	7	0	0	0	0	0	0	7
Gjithsej	73	2	2	0	0	0	1	78

Salla e leximit - Pasurimi i fondit librar - Fondi librar në biblioteka

Gushit	Salla e leximit	Pasurimi i fondit librar	Fondi librar në biblioteka
Rahovec	15	9	21471
Krushië	15	0	4551
Ratkoc	25	0	1837
Gjithsej	55	9	27859

Palestra sportive “Mizahir Isma”

Gjatë kësaj periudhe raportuese, në palestrën sportive “Mizahir Isma”, janë realizuar aktivitete të shumta sportive, si nga klubet e Komunës së Rahovecit, ashtu edhe nga ata ndërkombëtar.

Janë organizuar aktivitetetë shumta gjatë festave zyrtare të cilat I kemi patur nga Janar – Shtator 2023, kemi mbajtur turne në Futboll, Basketboll, Volejboll e disciplina tjera sportive, në bashkëpunim me Shoqatën “Hareja” kemi organizuar edhe aktivitet me fëmijët me nevoja të veçanta.

Klubet sportive, si: Basketballi, Hendboli, Futsalli kanë zhvilluar aktivitetetë shumta në Palestrën sportive “Mizahir Isma”, vlen të ceket se, më datë 16.2.2023, është mbajtur kupa e Kosovës në Basketboll “Final 8”.

PËRFUNDIMI

Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport, përvetë aktivitetetë parapara për periudhën kohore janar-shtator 2023 është angazhuar në aktivitetetë dhe punë të ndryshme si:

- Pranimi dhe shqyrtimi i lëndëve;
- Vizitë objekteve sportive;
- Takime me klube dhe shoqata sportive;
- Vizitë objekteve kulturore;
- Takim me rini dhe shoqata e organizata rimore;
- Organizimi i aktivitetetëve kulturore, rimore dhe sportive;
- Monitorimi i aktivitetetëve të subvencionuara nga DKRS-ja;
- Takime të irregullta në kuadër të DKRS-së;
- Përgaditje të raporteve favorë, mujore, tremujore, gjashtëmuajore,nëntëmuajore dhe vjetore.

Rahovec, 2023

Drejtor i DKRS-së

Afrim Dina